



## **Gazmend Gjoshaj**

Drejtor për Buxhet dhe Financa

Gazmend Gjoshaj lindi më 23 shtator 1980 në Mitrovicë. Ka të përfunduar Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina " ku ka përfunduar studimet në vitin 2003. Ka përvojë të gjatë dhe të konsoliduar profesionale në fushën e financave, sistemeve bankare si dhe në zhvillimin e resurseve humane.

Karrierën profesionale e ka filluar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht në Qendrën Rajonale të Aftësimeve Profesionale në Mitrovicë, ku ka punuar si trajner për Administrim biznesi dhe trajner për Vetpunësim nga data 03.05.2004 deri më 30.03.2007. Gjatë kësaj periudhe ka kontribuar në zhvillimin e aftësive profesionale dhe nxitjen e iniciativave të vetëpunësimit.

Pas kësaj përvoje, ai ka vazhduar karrierën e tij në sektorin bankar, ku ka qenë i angazhuar nga data 12.03.2007 deri më 16.01.2026 në Bankën Raiffeisen në Mitrovicë për afro (19) vite, duke ushtruar pozita të ndryshme përgjegjëse. Gjatë kësaj periudhe, ka fituar përvojë të thellë në operacione bankare, shërbime financiare, menaxhim klientësh dhe procese të brendshme bankare, duke demonstruar profesionalizëm, përkushtim dhe integritet të lartë. Gjatë karrierës së tij profesionale, është dalluar për profesionalizëm të lartë, integritet, përgjegjësi institucionale dhe aftësi të avancuara analitike e organizative. Kombinimi i formimit akademik me përvojen e gjatë praktike e ka bërë atë një kontribues të vlefshëm në institucionet ku ka vepruar, duke dhënë ndikim pozitiv në efikasitetin operacional në cilësinë e shërbimeve financiare.

Është i martuar dhe baba i tri vajzave .